



UDHËZIM NR.13.1

Tranzicioni drejt ISO 37001:2025 – Informacion për klientët dhe organizatat e interesuara për certifikim



European Quality & Safety Control

Rr. Sulejman Pasha, Pallati 70/1, Kati 1,

Nr.1; 1016 Tiranë

Cel: +35569 60 87 402

www.eqsc-cert.org

info@eqsc-cert.org

Ky udhëzim ofron informacion dhe orientime të përgjithshme për tranzicionin nga standardi ISO 37001:2016 në versionin e ri ISO 37001:2025. Ai synon të informojë organizatat e certifikuara nga EQSC, si dhe organizatat që aplikojnë për certifikim, mbi ndryshimet kryesore të standardit, afatet e tranzicionit dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i kalimit drejt versionit të ri të standardit. Dokumenti përshkruan veprimet që do të ndërmerren nga EQSC dhe pritshmëritë për organizatat e certifikuara gjatë kësaj periudhe, me qëllim sigurimin e një tranzicioni të kontrolluar dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të certifikimit, përfshirë IAF MD 30:2025 dhe udhëzimet e trupës akredituese DPA.



1. Hyrje

European Quality and Safety Control (EQSC) SHPK, si trupë certifikuese e akredituar për certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit Anti-Ryshfet sipas standardit ISO 37001, është e angazhuar të sigurojë përputhshmëri të vazhdueshme me kërkesat e akreditimit dhe standardet ndërkombëtare përkatëse.

Publikimi i standardit ISO 37001:2025, i cili zëvendëson versionin e mëparshëm ISO 37001:2016 dhe Amendamentin 1:2024, përcakton kërkesa të përditësuara për organizatat që zbatojnë sisteme të menaxhimit anti-ryshfet dhe për trupat certifikuese që kryejnë auditime dhe certifikime të këtyre sistemeve.

Procesi i tranzicionit drejt versionit të ri të standardit duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e ISO/IEC 17021-1 dhe udhëzimet e IAF MD 30:2025.

Ky udhëzim është përgatitur për të informuar organizatat e certifikuara nga EQSC, si dhe organizatat që aplikojnë për certifikim, mbi ndryshimet kryesore të standardit ISO 37001:2025, afatet e tranzicionit dhe mënyrën se si do të realizohet procesi i kalimit drejt versionit të ri të standardit.

Zbatimi i këtij udhëzimi synon të sigurojë një tranzicion të qartë dhe të kontrolluar për të gjitha organizatat e përfshira, duke garantuar që proceset e auditimit dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit anti-ryshfet të kryhen në mënyrë të qëndrueshme, transparente dhe në përputhje me kërkesat ndërkombëtare.

2. Fusha e Zbatimit

Ky udhëzim zbatohet për organizatat e certifikuara nga European Quality and Safety Control (EQSC) SHPK sipas standardit ISO 37001:2016, si dhe për organizatat që aplikojnë për certifikim sipas ISO 37001:2025.

Dokumenti përshkruan mënyrën se si do të realizohet tranzicioni nga ISO 37001:2016 në ISO 37001:2025, duke përfshirë afatet e tranzicionit, mënyrën e kryerjes së auditimeve të tranzicionit dhe pritshmëritë për organizatat gjatë këtij procesi.

Ky udhëzim zbatohet për të gjitha auditimet e kryera nga EQSC në kuadër të procesit të certifikimit të sistemeve të menaxhimit anti-ryshfet, duke përfshirë auditimet e certifikimit fillestar, auditimet mbikëqyrëse dhe auditimet e ricertifikimit, gjatë periudhës së tranzicionit drejt ISO 37001:2025.



3. Referenca Normative

- **ISO 37001:2016**
Sistemet e Menaxhimit Anti-Ryshfet — Kërkesat dhe udhëzimet për përdorim
- **ISO 37001:2016/Amd 1:2024**
Sistemet e menaxhimit kundër ryshfetit — Kërkesat me udhëzime për përdorim
Ndryshimi 1: Ndryshimet lidhur me veprimin për klimën
- **ISO 37001:2025**
Sistemet e Menaxhimit Anti-Ryshfet — Kërkesat dhe udhëzimet për përdorim
- **ISO/IEC 17021-1:2015**
Vlerësimi i përputhshmërisë — Kërkesat për trupat që ofrojnë auditim dhe certifikim të sistemeve të menaxhimit — Pjesa 1: E përgjithshme
- **IAF MD 30:2025**
Mandatory Document for the Transition to ISO 37001:2025
- **DA-IN-007 V.1 26-11-2025**
Udhëzues për kalimin nga standardi ISO 37001:2016 në ISO 37001:2025

4. Statusi i Zbatimit dhe Tranzicioni

Ky udhëzim përcakton mënyrën se si do të menaxhohet tranzicioni drejt standardit ISO 37001:2025 për organizatat e certifikuara dhe për organizatat që aplikojnë për certifikim.

EQSC do të fillojë zbatimin e kërkesave të ISO 37001:2025 për aktivitetet e certifikimit pas përfundimit me sukses të procesit të tranzicionit dhe pas përfundimit të procesit të akreditimit sipas këtij standardi, në përputhje me kërkesat e trupit të akreditimit dhe afatet e përcaktuara nga IAF MD 30:2025.

Deri në përfundimin e këtij procesi, EQSC do të vazhdojë të kryejë auditime dhe certifikime sipas standardit aktual ISO 37001:2016, ndërkohë që do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e tranzicionit drejt ISO 37001:2025.



5. Periudha e Tranzicionit dhe Afatet Kohore

- **ISO 37001:2025** është publikuar në 28 Shkurt 2025 dhe periudha e tranzicionit është përcaktuar **24 muaj nga data e publikimit**, përfundim **28 Shkurt 2027**.
- Klientë e EQSC të certifikuar aktualisht sipas **ISO 37001:2016** duhet të kryejnë tranzicionin drejt **ISO 37001:2025** brenda kësaj periudhe tranzicioni.
- Fillimi i certifikimit fillestar për klientët në ISO 37001:2025 nga EQSC do të jetë 31 Gusht 2026, pas përfundimit të tranzicionit të suksesshëm dhe akreditimit sipas këtij standardi.
- Periudha e tranzicionit për klientët e certifikuar shtrihet deri më 28 Shkurt 2027.
- **Pas datës 28 Shkurt 2027**, certifikatat sipas **ISO 37001:2016** nuk do të jenë më të vlefshme.
- Tranzicioni për organizatat e certifikuar do të kryhet zakonisht **gjatë auditimeve mbikëqyrëse ose auditimeve të ricertifikimit**, brenda periudhës së tranzicionit.

6. Ndryshimet kryesore nga ISO 37001:2016 në ISO 37001:2025

Standardi **ISO 37001:2025** sjell përmirësime dhe sqarime të rëndësishme krahasuar me versionin **ISO 37001:2016**, duke harmonizuar strukturën e tij me standardet më të fundit të sistemeve të menaxhimit dhe duke theksuar më shumë kërkesat për kulturën e integritetit, menaxhimin e rrezikut të korrupsionit dhe funksionin anti-bribery.

Ndryshimet kryesore përfshijnë:

- **Struktura dhe harmonizimi** – Standardi është përafruar plotësisht me strukturën e harmonizuar të sistemeve të menaxhimit (Harmonized Structure), duke lehtësuar integrimin me standarde të tjera të sistemeve të menaxhimit.
- **Ndryshimet klimatike** – Në përputhje me ndryshimet e fundit të standardeve ISO, organizatat duhet të marrin në konsideratë nëse çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike janë relevante për kontekstin e tyre.
- **Konteksti i organizatës dhe palët e interesuara** – Theksohet më shumë nevoja për të analizuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm dhe pritshmëritë e palëve të interesuara që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit anti-ryshfet.
- **Menaxhimi i konflikteve të interesit dhe funksioni anti-bribery** – Kërkesat për identifikimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit janë sqaruar më tej dhe është theksuar roli, autoriteti dhe pavarësia e funksionit anti-bribery.



- **Kultura e integritetit dhe ndërgjegjësimi** – Standardi thekson rëndësinë e promovimit të një kulture integriteti dhe etikë në organizatë, si dhe nevojën për trajnime dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm të personelit.
- **Analiza e riskut dhe due diligence** – Organizatat duhet të kryejnë vlerësime të strukturuar të rreziqeve të korrupsionit dhe të zbatojnë procese të përshtatshme të due diligence për partnerët, projektet dhe transaksionet.
- **Kontrollet financiare dhe jo-financiare** – Janë përforcuar kërkesat për kontrollet operative që mbështesin parandalimin dhe zbulimin e ryshfetit.
- **Raportimi dhe investigimi** – Standardi thekson rëndësinë e mekanizmave të besueshëm të raportimit dhe menaxhimit të hetimeve në lidhje me shkeljet e mundshme të sistemit anti-ryshfet.
- **Terminologjia dhe harmonizimi me standarde të tjera** – Është përmirësuar terminologjia dhe është rritur harmonizimi me standarde të tjera të sistemeve të menaxhimit si **ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 45001**.
- **Governance dhe informacioni i dokumentuar** – Është theksuar rëndësia e qeverisjes efektive dhe menaxhimit të informacionit të dokumentuar që mbështet funksionimin e sistemit anti-ryshfet.

Këto ndryshime synojnë të forcojnë efektivitetin e sistemeve të menaxhimit anti-ryshfet dhe të mbështesin organizatat në identifikimin, parandalimin dhe adresimin e rreziqeve të korrupsionit.

7. Veprimet e klientëve të EQSC për tranzicionin sipas ISO 37001:2025

Organizatat që aktualisht janë të certifikuara sipas ISO 37001:2016 duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e Sistemit të Menaxhimit Anti-Ryshfet me kërkesat e standardit të ri ISO 37001:2025 brenda periudhës së tranzicionit të përcaktuar.

Në këtë kuadër, organizatat e certifikuara duhet të marrin në konsideratë veprimet e mëposhtme:

- Njohja me kërkesat e standardit të ri – Organizata duhet të analizojë kërkesat e standardit ISO 37001:2025 dhe të identifikojë ndryshimet kryesore krahasuar me versionin ISO 37001:2016.
- Kryerja e një analize të boshllëqeve (gap analysis) – Rekomandohet të kryhet një vlerësim i sistemit ekzistues për të identifikuar diferencat midis praktikave aktuale të organizatës dhe kërkesave të standardit të ri.
- Përditësimi i sistemit të menaxhimit anti-ryshfet – Në bazë të analizës së kryer, organizata duhet të përditësojë politikat, procedurat, kontrollet dhe informacionin e dokumentuar për të reflektuar kërkesat e reja të standardit.



- Rishikimi i analizës së riskut dhe proceseve të due diligence – Organizata duhet të sigurojë që proceset për identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të korrupsionit të jenë në përputhje me kërkesat e përditësuara të standardit.
- Trajnimi dhe ndërgjegjësimi i personelit – Personeli përkatës duhet të informohet dhe të trajnohet mbi ndryshimet e standardit dhe mbi përditësimet e bëra në sistemin e menaxhimit anti-ryshfet.
- Kryerja e auditimit të brendshëm dhe rishikimit të menaxhimit – Para auditimit të tranzicionit, organizata duhet të sigurojë që sistemi i përditësuar është vlerësuar përmes auditimit të brendshëm dhe rishikimit nga menaxhmenti.
- Planifikimi i auditimit të tranzicionit me EQSC – Organizatat duhet të koordinohen me EQSC për planifikimin e auditimit të tranzicionit drejt ISO 37001:2025, i cili zakonisht kryhet gjatë një auditimi mbikëqyrës ose gjatë auditimit të ricertifikimit.

EQSC do të mbështesë klientët e saj gjatë kësaj periudhe tranzicioni duke ofruar informacion dhe orientime të përgjithshme mbi kërkesat e standardit dhe procesin e certifikimit.

Tranzicioni drejt ISO 37001:2025 duhet të përfundojë brenda afatit të përcaktuar të tranzicionit, jo më vonë se 28 Shkurt 2027. Pas kësaj date, certifikatat sipas ISO 37001:2016 nuk do të jenë më të vlefshme.

8. Veprimet që duhet të ndërmarrin organizatat që duan të certifikohen sipas ISO 37001:2025

Organizatat që synojnë të marrin **certifikimin e Sistemit të Menaxhimit Anti-Ryshfet** nga EQSC duhet të ndërmarrin veprimet e mëposhtme për të garantuar një proces të suksesshëm dhe në përputhje me kërkesat e standardit **ISO 37001:2025**:

- **Njohja me kërkesat e standardit ISO 37001:2025** – Organizata duhet të analizojë kërkesat e standardit të ri, duke marrë në konsideratë ndryshimet kryesore nga versioni 2016 dhe drejtimet e EQSC për certifikimin.
- **Kryerja e një vlerësimi paraprak (gap analysis)** – Organizata duhet të identifikojë boshllëqet midis praktikave ekzistuese dhe kërkesave të standardit të ri, duke përgatitur një plan veprimi për përmirësime.
- **Përditësimi i politikave dhe procedurave** – Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme duhet të harmonizohen me kërkesat e ISO 37001:2025, duke përfshirë menaxhimin e riskut, funksionin anti-bribery, konfliktet e interesit, dhe raportimin e dyshimeve për korrupsion.



- **Trajnimi i personelit dhe ndërgjegjësimi** – Personeli përgjegjës duhet të trajnohet mbi standardin e ri, mbi përgjegjësitë e tij dhe mbi veprimet e kërkuara për të siguruar përputhshmërinë me ISO 37001:2025.
- **Kryerja e auditimit të brendshëm dhe rishikimit nga menaxhmenti** – Organizata duhet të vlerësojë sistemin e saj përpara auditimit nga EQSC, për të siguruar që të gjitha kërkesat e standardit janë të përmbushura.
- **Aplikimi për certifikim tek EQSC** – Organizatat që duan të certifikohen duhet të aplikojnë tek EQSC duke planifikuar auditimin sipas procedurave të certifikimit.

Afatet e rëndësishme:

- **Para 31 Gusht 2026** – Organizatat mund të aplikojnë për certifikim fillestar sipas **ISO 37001:2016** gjatë periudhës së tranzicionit.
- **Pas 31 Gusht 2026** – Çdo aplikim i ri për certifikim duhet të bëhet **drejt ISO 37001:2025**; certifikimi nuk mund të kryhet më sipas versionit 2016 pas kësaj date.

EQSC do të sigurojë orientime, udhëzime dhe mbështetje gjatë gjithë procesit të certifikimit, për të garantuar që organizatat të arrijnë përputhshmërinë me standardin e ri dhe të përfitojnë certifikatën në mënyrë të besueshme dhe të dokumentuar.

Thirrje për veprim

European Quality and Safety Control (EQSC) ju fton të rishikoni sistemin tuaj të menaxhimit në përputhje me ISO 37001:2025 dhe të planifikoni tranzicionin ose certifikimin fillestar.

Na kontaktoni:

[ +355696087402] | [ info@eqsc-cert.org] | [ www.eqsc-cert.org]